



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik

Zyra e Kryetarit

01-Nr 400 3538/196
Kaçanik, 26.10.2016

Duke u bazuar në nenin 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të komunës së Kaçanikut, pas propozimit dhe konsultimit me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në kuadër të drejtave dhe përgjegjësi si Zyrtar Kryesor Administrativ, kryetari i komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare për rregullimin dhe ndërtimin e disa rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut

- I. Me këtë vendim lejohen mjetet buxhetore në shumë prej 66,918.80€, për për rregullimin dhe ndërtimin e disa rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut
 1. Asfaltimi i rrugës "Mulliri i Kuq"-Kovaqec
 2. Asfaltimi i rrugës "Kadri Deda"-Dogana
 3. Asfaltimi i rrugës "Reshat Shehu"-te Përroi i Rakocit
 4. Sanimi i pjesëve të asfaltit të dëmtuar në zonën urbane dhe rurale
 5. Shtrimi me kubëza të betonit të trotuarit Duraj-Elezaj
 6. Asfaltimi rrugës "Bajram Fuga"-Biqec
 7. Shtrimi me kubëza betoni i rrugëve "Halim Çaka" dhe "Sylejman Çaka"-Bob
 8. Shtrimi me kubëza të betonit i krahut të rrugës "Selim Shehu"
 9. Ndërtimi i kanalit të hapur në lagjen Manëve në fshatin Stagovë,
 10. Asfaltimi i rrugës "Zekir Dardhishta"-Dushkajë,
 11. Shtrimi me kubëza i degëzimit të rrugës "Kjani Bela"-Kaçanik
- II. Mjetet buxhetore nga pika 1 e këtij vendimi do të ndahen nga kategoria buxhetore "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në zonat urbane dhe rurale" me Kod 43974, nga Programi Buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Besim Ilazi
Kryetar i komunës

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i komunës
2. Drejtoria për Financa dhe Ekonomi dhe
3. Arkivi komunal.

